

Nga koncepti i pilotuar i Njësive të Trajnimit për Mësues dhe Instruktorë drejt mekanizmit të Njësive të Zhvillimit të Shkollave/Qendrave të AFP

M.Andoni

A.Mustafai

Tiranë, 3 shkurt 2017

Koncepti i pilotuar i Njesisë së Trajnimit (NJT)

Roli dhe përbërja

- NJT u pilotua si një strukturë përgjegjëse për ZHVP të mësuesve dhe instruktorëve në nivel SHPP/DRFPP.
- NJT zhvillon veprimtarinë në kuadrin e Departamenteve mësimore, si grupime profesionale të mësuesve e instruktorëve që trajtojnë lëndë, module e praktika mësimore profesionale në drejtime/profile mësimor të caktuara.
- NJT përbëhet nga mësues dhe instruktorë përfaqësues të Departamenteve mësimore.
- Antarët e NJT emërtohen “trajgues”.
- Kur NJT përbëhet nga dy apo më shumë antarë, një nga antarët emërohet “përgjegjës” i saj.
- Në SHPP/DRFPP me numër të vogël mësimdhënësish, NJT mund të përbëhet nga vetëm një trajgues.
- Antarët e përgjegjësi i NJT emërohen nga drejtori i SHPP/DRFPP

Koncepti i pilotuar i Njësisë së Trajnimit (NJT)

Funksionet dhe detyrat ⁽¹⁾

- **Koordinimi dhe mbështetja e trajnimit të vazhdueshëm (in-service) në nivel ofruesi të mësuesve dhe instruktorëve:**
 - Të mbikqyrë dhe analizojë gjendjen, si dhe të përcaktojnë problematikën e procesit mësimor.
 - Të analizojë nevojat për trajnim të vazhdueshëm të mësuesve dhe instruktorëve.
 - Të njohë drejtuesit dhe mësuesit e instruktorët me gjendjen, problematikat dhe nevojat për trajnim të vazhdueshëm.
 - Të marrë informacion për ofruesit dhe ofertat e trajnimit të mësuesve e instruktorëve në nivelin lokal dhe kombëtar.
 - Të përgatitë programin dhe buxhetin vjetor të veprimtarive për trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe instruktorëve.

Koncepti i pilotuar i Njësisë së Trajnimit (NJT)

Funksionet dhe detyrat ⁽²⁾

- Të organizojë, koordinojë dhe mbështesë trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve.
- Të kryejë demonstrime dhe forma të tjera trajnimi individual e në grup
- Të mbështetë mësuesit dhe instruktorët me këshilla, udhëzime, shembuj, literaturë dhe forma të tjera.
- Të krijojë dhe mbajë lidhje të vazhdueshme me institucionet, forumet dhe rrjetet on-line (kombëtare dhe ndërkombëtare) për ZHVP.
- Të administrojë dokumentacionin për trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe instruktorëve (në hard-copy dhe në format elektronik).

Detyrat e Përgjegjësit të NJT

- Të përgatitë programin vjetor të veprimtarive dhe buxhetin për trajnimin e vazhdueshëm mësuesve dhe instruktorëve.
- Të miratojë (së bashku me drejtorin) programet vjetore të veprimtarive për trajnimin e e vazhdueshëm mësuesve dhe instruktorëve
- Të koordinojë, mbikqyrë dhe mbështetë realizimin e veprimtarive për trajnimin e vazhdueshëm mësuesve dhe instruktorëve.
- Të organizojë dhe drejtojë mbledhjet e NJT-së.
- Të raportojë te drejtori i SHPP/DRFPP-së për ecurinë e procesit të ZHVP të mësuesve dhe instruktorëve.
- Të përgatitë dokumentacionin zyrtar të NJT-së (në hard-copy dhe elektronik)

Mekanizmi i Njesisë së Zhvillimit (NJZH)

Roli dhe përbërja

- NJZH si një strukturë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e veprimtarive zhvillimore të SHPP/DRFPP.
- NJZH zhvillon veprimtarinë në kuadrin e Departamenteve mësimore.
- NJZH përbëhet nga mësues dhe instruktorë përfaqësues të Departamenteve mësimore.
- Antarët e NJZH emërtohen “koordinatorë”.
- Kur NJZH përbëhet nga dy apo më shumë antarë, një nga antarët emërohet “përgjegjës” i saj.
- Në SHPP/DRFPP me numër të vogël mësimdhënësish, NJZH mund të përbëhet nga vetëm një koordinators.
- Antarët dhe përgjegjësi i NJZH emërohen nga drejtori i SHPP/DRFPP

Mekanizmi i Njësisë së Zhvillimit (NJZH)

Funksonet ⁽¹⁾

- **Funksioni i trajnimit** - Koordinimi dhe mbështetja e trajnimit të vazhdueshëm (in-service) në nivel ofruesi të mësuesve dhe instruktorëve (njësoj si te NJT e pilotuar).
- **Funksioni i mentorimit** - Koordinimi dhe mbështetja e kualifikimit praktik të mësuesve dhe instruktorëve të rinj, të sapoemëruar.
- **Funksioni i zhvillimit kurrikular** - Koordinimi dhe moderimi i procesit të hartimit dhe përshtatjes së vazhdueshme të skelet-kurrikulës apo programit mësimor në nivel SHPP/DRFPP.
- **Funksioni PASO** - Koordinimi dhe garantimi i lidhjeve të SHPP dhe DRFPP me bizneset lokale, veçanërisht për kryerjen e praktikave profesionale të nxënësve e kursantëve.

Mekanizmi i Njesisë së Zhvillimit (NJZH)

Funksionet ⁽²⁾

- **Funksioni i këshilluesit të karrierës** – Kryerja e veprimtarive për orientimin dhe këshillimin e nxënësve dhe kursantëve për të zgjedhur shkollimin dhe punësimin e tyre të ardhshëm.
- **Funksioni i marketingut të shkollës/qendrës** – Kryerja e veprimtarive për rritjen e imazhit të shkollës/qendrës në komunitet
- **Funksioni i zhvillimit përmes projekteve** – Konceptimi, aplikimi për fonde dhe realizimi i projekteve zhvillimore të shkollës/qendrës
- **Funksioni i “ gjurmimit”** – Marrja e të dhënave për ecurinë e karrierës së nxënësve dhe kursantëve pas përfundimit të shkollës apo kursit

Kërkesat për Koordinatorët dhe Përgjegjësin e NJZH

➤ Koordinatori:

- I emëruar me kohë të plotë në SHPP/DRFPP-në.
- I diplomuar në një nga drejtimet/profilet profesionale që trajton Departamenti mësimor përkatës.
- Me përvojë mësimdhënieje (teorike dhe/ose praktike) në AFP, jo më pak se 5 vjet.
- Me kualifikime e përvoja praktike për detyrat që do të kryejë.
- Përdor kompjuterin, internetin dhe mediat e mjetet e tjera didaktike.
- Mundësisht, zotëron një gjuhë të huaj.
- Me aftësi të mira organizative, të komunikimit dhe të punës në grup.
- Gëzon respektin e mësuesve të tjerë dhe të nxënësve/kursantëve.

➤ Përgjegjësi (përveç kërkesave të mësipërme):

- I diplomuar në një nga drejtimet/profilet që ofron SHPP/DRFPP-ja.
- Me përvojë mësimdhënieje (teorike dhe/ose praktike) në AFP, jo më pak se 8 vjet.

Statusi i NJZH dhe i antarëve të saj

- NJZH – mekanizëm i brendshëm, formal, me funksionet e përmendura më sipër.
- Stafi i NJZH: nga mësimdhënësit me kohë të plotë, emërohen nga drejtori sipas kriterëve të caktuar (me miratimin e Bordit).
- Kriteret e përzgjedhjes, funksionet dhe detyrat e antarëve të NJZH përcaktohen me akte nënligjore.
- Antarët e NJZH me ngarkesë mësimore të reduktuar, sipas kriterëve të caktuar.
- Antarët e NJZH shpërndajnë optimalisht ngarkesën mësimore, për të mundur kryerjen e detyrave të tjera.
- Drejtorja e SHPP/DRFPP-së krijon kushte që NJZH të kryejë funksionet (zyrë e pajisur me kompjuter, printer, fotokopjues, internet, materiale kancelarie etj.).
- Antarët e NJZH trajnohen për aspekte të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e tyre.
- Stafi mësimdhënës e mjediset e SHPP/DRFPP vihen në dispozicion të NJZH për të kryer veprimtaritë e saj.
- Buxheti i SHPP/DRFPP me një zë të veçantë për financimin e veprimtarive të NJZH.

Roli i Drejtuesve të SHPP/DRFPP-ve

- Të angazhohen aktivisht në këtë nismë.
- Të emërojnë si antarë dhe përgjegjës të NJZH-së (me miratimin e Bordit të ofruesit) mësues dhe instruktorë që plotësojnë kërkesat.
- Të mbikqyrin veprimtarinë e NJZH-së
- Të krijojnë kushte për realizimin e suksesshëm të veprimtarive të NJZH-së.

Kërkesa për institucionalizimin e NJZH-ve

- Vullnet politik nga vendimmarrësit për të miratuar dhe zbatuar këtë ndërhyrje sistemike.
- Gadishmëri nga vetë SHPP-të dhe DRFPP-të për të zbatuar këtë nismë.
- Kuadër ligjor të përshtatshëm dhe të detajuar.
- Parashikimin e buxheteve të veçanta për funksionimin e NJZH-ve.
- Mbështetje institucionale, teknike dhe financiare nga institucionet kombëtare dhe donatorët/projektet ndërkombëtare dhe dypalëshe.